

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, i ndryshuar.
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/ Transpozim i Direktivës
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva e Këshillit 2011/7/BE , datë 20 maj 1975 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 16 shkurt 2011, “Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare”; Celex: 32011L000, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 48, datë 23.2.2011, f. 1–10
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Ky projektligj është në përputhje me politikat e Këshillit të Ministrave lidhur me procesin e integritetit të Shqipërisë në BE dhe me përparimin në bisedimet e anëtarësimit. Konkretisht: Shtylla 1: Shqipëria Evropiane, nënseksioni 1.1: Shqipëria vend anëtar i Bashkimit Evropian, ku një ndër objektivat specifike është përparimi në procesin e negociatave të anëtarësimit duke përmbushur plotësisht kriteret e anëtarësimit dhe mbyllja e negociatave për të gjithë kapitujt në vitin 2027. Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me Kapitullin 20 të legjislacionit evropian buron edhe nga Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Këto dispozita detyrojnë Shqipërinë që teknikisht të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet siç duhet.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	19/05/2026 – 16/06/2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	25/06/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	Po,
NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	11/06/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MEI – Nr. 12

TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Hega Ismaili, Drejtoria e Politikave të Tregut të Brendshëm, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit E-mail: Hega.Ismaili@ekonomia.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, i ndryshuar, paraqet mangësi në raport me kërkesat e Direktivës 2011/7/BE, duke mos siguruar harmonizim të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Problemet kryesore lidhen me përkufizime të paplota të subjekteve të përfshira në ligj, rregullim jo të plotë të afateve të pagesave dhe kamatëvonesave, si dhe mekanizma jo mjaftueshëm efektivë për mbledhjen dhe ekzekutimin e detyrimeve të papaguara. Këto mangësi ndikojnë negativisht në sigurinë juridike, likuiditetin e sipërmarrjeve, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), si dhe në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian. Për këtë arsye, ndërhyrja e qeverisë konsiderohet e nevojshme për të siguruar një kuadër ligjor të harmonizuar, efektiv dhe në përputhje me standardet e BE-së. Analiza e legjislacionit në fuqi ka evidentuar se, ligji ende nuk siguron transpozim të plotë të Direktivës 2011/7/BE. Për këtë arsye propozohet rishikimi i tij, me qëllim harmonizimin e plotë me acquis të Bashkimit Evropian, përmirësimin e sigurisë juridike dhe forcimin e disiplinës së pagesave në transaksionet tregtare. Problematikat e evidentuara në ligjin aktual në fuqi janë: • Përputhshmëri e pjesshme me legjislacionin e Bashkimit Evropian: Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, i ndryshuar, nuk është plotësisht i harmonizuar me Direktivën 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare”. Në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”, është evidentuar nevoja për përditësimin e kuadrit ekzistues ligjor, me qëllim sigurimin e përafrimit të plotë me acquis të BE-së. • Mangësi në përkufizimet dhe fushën e zbatimit të ligjit: Ligji aktual nuk përfshin në mënyrë të plotë konceptet e “autoritetit publik” dhe “sipërmarrjes” sipas standardeve të Direktivës, duke përjashtuar kategori të caktuara subjektsh, si profesionet e lira, tregtarët individë dhe subjektet publike të rregulluara nga e drejta publike. Kjo ka krijuar boshllëqe në zbatimin e ligjit dhe pasiguri juridike në marrëdhëniet tregtare. • Mangësi në rregullimin e afateve të pagesave dhe kamatëvonesave: Dispozitat aktuale nuk përcaktojnë në mënyrë të plotë dhe të qartë mekanizmat për llogaritjen automatike të kamatëvonesave, afatet e pagesës dhe kufizimin e praktikave kontraktuale abuzive. Si pasojë, krijohen vonesa në pagesa dhe vështirësi në mbrojtjen efektive të kreditorëve. • Vështirësi në mbledhjen dhe ekzekutimin e detyrimeve të papaguara: Kuadri aktual procedural nuk garanton mekanizma mjaftueshëm efikasë për ekzekutimin e shpejtë të detyrimeve të pakundërshtuara, duke sjellë vonesa në procedurat gjyqësore dhe duke ndikuar negativisht në likuiditetin e sipërmarrjeve. • Ndikim negativ në likuiditetin dhe konkurrueshmërinë e sipërmarrjeve: Vonesat në pagesa dhe mungesa e një kuadri të harmonizuar me standardet evropiane kanë sjellë vështirësi financiare për	

operatorët ekonomikë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), duke ndikuar negativisht në klimën e biznesit dhe konkurrueshmërinë në treg.

Grupet e prekura nga këto problematika janë:

- Qeveria dhe institucionet publike, të cilat kanë detyrimin të respektojnë afatet ligjore të pagesave dhe të zbatojnë mekanizmat e kamatëvonesave dhe disiplinës financiare në transaksionet tregtare.
- Operatorët ekonomikë (bizneset), veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), të cilat preken drejtpërdrejt nga vonesat në pagesa, duke ndikuar në likuiditetin, aftësinë për investim dhe qëndrueshmërinë financiare.
- Furnitorët dhe kreditorët tregtarë, të cilët përballen me rrezikun e vonesave të pagesave dhe kostove shtesë të financimit ose rikuperimit të borxheve.
- Sistemi gjyqësor dhe përmbarimor, i cili trajton mosmarrëveshjet që lidhen me pagesat e vonuara dhe zbatimin e detyrimeve kontraktore.
- Sektori financiar, i cili ndikohet indirekt nga kërkesa për financim afatshkurtër të bizneseve për shkak të vonesave në pagesa dhe nga niveli i likuiditetit në treg.
- Shoqëria në përgjithësi (qytetarët/konsumatorët), të cilët preken në mënyrë indirekte përmes ndikimit që ka stabiliteti financiar i bizneseve në çmimet, punësimin dhe cilësinë e shërbimeve në treg.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat kryesorë që synohen nëpërmjet miratimit të shtesave dhe ndryshimeve të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, i ndryshuar .

Përafrimi i plotë i ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, të ndryshuar, me Direktivën 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare”.

1. Forcimi i sigurisë juridike dhe harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare.
2. Përmirësimi i qartësisë dhe uniformitetit të kuadrit rregullator përmes plotësimit dhe standardizimit të përkufizimeve që lidhen me subjektet, transaksionet tregtare dhe detyrimet e pagesës, me qëllim zbatimin e njëtrajtshëm nga të gjitha palët e interesuara.
3. Rritja e sigurisë juridike në marrëdhëniet tregtare, përmes eliminimit të paqartësive dhe përcaktimit të qartë të të drejtave dhe detyrimeve të palëve.
4. Përmirësimi i likuiditetit të sipërmarrjeve, veçanërisht i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes reduktimit të ndikimit negativ të pagesave të vonuara.
5. Reduktimi, deri në fund të vitit 2028, me të paktën 20% i numrit të rasteve të raportuara të pagesave të vonuara në transaksionet ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe institucioneve publike, përmes forcimit të zbatimit të afateve ligjore të pagesës.
6. Rritja, deri në fund të vitit 2029, në të paktën 85% e nivelit të respektimit të afateve kontraktuale të pagesave nga institucionet publike, bazuar në monitorimet institucionale dhe raportimet periodike.

7. Përmirësimi, deri në fund të vitit 2029, i likuiditetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), i matur përmes uljes së nevojës për financim afatshkurtër të jashtëm si pasojë e vonësive në pagesa.

8. Forcimi, deri në fund të vitit 2028, i mekanizmave ligjorë dhe administrativë për zbatimin e kamatëvonesës automatike dhe kompensimit të kostove të rikuperimit, duke siguruar zbatim uniform nga të gjitha institucionet publike.

9. Rritja, deri në fund të vitit 2029, e nivelit të ndërgjegjësimit dhe zbatimit të rregullave për pagesat në kohë në sektorin publik dhe privat, përmes aktiviteteve informuese, udhëzuese dhe monitoruese institucionale.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Në kuadër të adresimit të problematikave të evidentuara, janë identifikuar disa opsione kryesore politikash:

Për adresimin e problematikave të identifikuara janë shqyrtuar katër opsione politike, përfshirë një opsion jorregullator.

Opsioni 0: Status quo (mosndërrhyrja)

Ky opsion konsiston në ruajtjen e kuadrit aktual ligjor pa ndërrhyrje legjislative ose administrative.

Avantazhet

- Nuk krijon kosto shtesë ligjore, administrative apo financiare.
- Nuk kërkon ndryshime në procedurat ekzistuese të institucioneve publike dhe operatorëve ekonomikë.
- Nuk kërkon trajnime apo masa përshtatëse.

Disavantazhet

- Nuk adreson mangësitë e identikuara në ligjin nr. 48/2014.
- Nuk siguron harmonizimin e plotë me Direktivën 2011/7/BE.
- Vazhdon pasiguria juridike dhe paqartësitë në interpretimin e dispozitave.
- Nuk përmirëson mbrojtjen e kreditorëve dhe të NVM-ve.
- Ndikon negativisht në përmbushjen e detyrimeve të integritetit evropian.

Opsioni 1: Masa jorregullatore

Ky opsion parashikon përmirësimin e zbatimit të kuadrit ekzistues nëpërmjet udhëzimeve administrative, aktiviteteve ndërgjegjëse, trajnimeve për institucionet publike dhe biznesin, si dhe promovimit të praktikave të mira të pagesave.

Avantazhet

- Kosto relativisht e ulët financiare dhe administrative.
- Mund të zbatohet në afat të shkurtër.
- Kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohjes së detyrimeve ligjore ekzistuese.
- Mund të sjellë përmirësime të kufizuara në zbatimin praktik të ligjit.

Disavantazhet

- Nuk eliminon mangësitë e kuadrit ligjor ekzistues.
- Nuk siguron harmonizim me Direktivën 2011/7/BE.
- Nuk zgjidh problemet që lidhen me përkufizimet, afatet e pagesës dhe mekanizmat e mbrojtjes së kreditorëve.
- Efektiviteti i masave varet nga niveli i bashkëpunimit vullnetar të aktorëve të përfshirë.

Opsioni 2: Përafrim i pjesshëm i Direktivës

Ky opsion parashikon ndërhyrje të kufizuara vetëm në disa dispozita të ligjit, duke harmonizuar Direktivën e BE-së pjesërisht, kryesisht ato që lidhen me afatet e pagesës, kamatëvonesat dhe disa elemente procedurale.

Avantazhet

- Kosto më e ulët krahasuar me reformimin e plotë të ligjit.
- Adreson disa nga problematikat më urgjente.
- Mund të zbatohet më shpejt sesa një reformë e plotë.

Disavantazhet

- Siguron vetëm harmonizim të pjesshëm me acquis-in e Bashkimit Evropian.
- Lë të pazgjidhura një pjesë të mangësive strukturore të ligjit.
- Mund të krijojë fragmentim të mëtejshëm të kuadrit ligjor.
- Nuk garanton mbrojtje të plotë dhe efektive për kreditorët.

Opsioni 3: Ndryshime të plota të ligjit dhe transpozim i plotë i Direktivës 2011/7/BE

Ky opsion parashikon rishikimin e plotë të dispozitave të ligjit nr. 48/2014 për të siguruar harmonizim të plotë me Direktivën 2011/7/BE dhe adresimin e të gjitha mangësive të identifikuara.

Avantazhet

- Siguron harmonizim të plotë me acquis-in e Bashkimit Evropian.
- Përbush detyrimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian.
- Rrit sigurinë juridike dhe qartësinë e kuadrit ligjor.
- Forcon mbrojtjen e kreditorëve dhe veçanërisht të NVM-ve.
- Përmirëson disiplinën e pagesave dhe likuiditetin e sipërmarrjeve.
- Kontribuon në përmirësimin e klimës së biznesit dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë.

Disavantazhet

- Kërkon përshtatjen e institucioneve publike dhe operatorëve ekonomikë me dispozitat e reja.
- Mund të kërkojë aktivitete trajnuese dhe informuese gjatë fazës fillestare të zbatimit.
- Shoqërohet me kosto administrative të kufizuara për zbatimin dhe monitorimin fillestar.

Opsioni i preferuar

Pas vlerësimit të alternativave të mësipërme, opsioni 3 vlerësohet si alternativa më e përshtatshme, pasi është i vetmi opsion që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse problematikat e identifikuar, siguron harmonizimin e plotë me Direktivën 2011/7/BE, përmbush detyrimet e integritetit evropian dhe krijon një kuadër më efektiv për mbrojtjen e kreditorëve dhe funksionimin e tregut.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Propozimi, hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, të ndryshuar (opsioni i preferuar), në përputhje të plotë me Direktivën 2011/7/BE, synon të përmirësojë funksionimin e tregut të pagesave në transaksionet tregtare dhe të rrisë disiplinën financiare. Ndikimet e këtij opsioni vlerësohen kryesisht pozitive dhe të karakterizuara nga përmirësime strukturore në sistemin e pagesave, pa kosto të konsiderueshme për buxhetin e shtetit.

Ndikimi ekonomik

Ndryshimet e propozuara nuk sjellin kosto të drejtpërdrejta shtesë për buxhetin e shtetit, pasi nuk krijojnë detyrime të reja financiare dhe nuk parashikojnë ngritje strukturash të reja administrative. Kostot e zbatimit lidhen kryesisht me përshtatjen dhe trajnimin e administratës publike dhe përditësimin e procedurave ekzistuese, të cilat vlerësohen si të kufizuara dhe të përballueshme brenda buxheteve aktuale institucionale. Në afat të mesëm, pritët ulje e kostove që lidhen me kamatëvonesat e shkaktuara nga pagesat e vonuara të institucioneve publike.

Ndikimet për operatorët ekonomikë

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe përafrimi me standardet e BE-së do të rrisë sigurinë juridike dhe qartësinë në marrëdhëniet kontraktuale. Kjo pritët të ndikojë pozitivisht në likuiditetin e sipërmarrjeve, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), duke reduktuar vonesat në pagesa dhe nevojën për financim të jashtëm afatshkurtër. Gjithashtu, vendosja e afateve të qarta dhe mekanizmave automatikë të kamatëvonesës rrit parashikueshmërinë dhe forcon disiplinën kontraktuale në treg.

Ndikimet për konsumatorët indirekt

Edhe pse ligji nuk i drejtohet drejtpërdrejt konsumatorëve, përmirësimi i likuiditetit dhe funksionimit të sipërmarrjeve ka ndikim indirekt pozitiv në treg, përmes stabilizimit të aktivitetit ekonomik dhe rritjes së qëndrueshmërisë së shërbimeve dhe produkteve të ofruara.

Ndikimet në institucionet publike dhe sistemin e drejtësisë

Ndryshimet pritët të ndikojnë në rritjen e disiplinës së pagesave nga institucionet publike, si dhe në përmirësimin e procedurave të brendshme financiare dhe administrative. Gjithashtu, parashikimi i mekanizmave më të qartë për ekzekutimin e detyrimeve pritët të reduktojë ngarkesën gjyqësore dhe të përshpejtojë proceset e lëshimit të urdhrave të ekzekutimit për detyrimet e pakundërshtuara.

Në tërësi, opsioni i preferuar sjell përfitime të rëndësishme cilësore në rritjen e sigurisë juridike, përmirësimin e klimës së biznesit dhe harmonizimin me acquis të Bashkimit Evropian, pa krijuar ndikime të konsiderueshme negative buxhetore.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar (Opsioni 3) i politikës është harmonizimi i plotë i ligjit nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare", të ndryshuar, me **Direktivën 2011/7/BE**, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e luftimit të vonesave në pagesat në transaksionet tregtare.

Zgjedhja e harmonizimit të plotë siguron që dispozitat e legjislacionit kombëtar të jenë në përputhje me standardet dhe parimet e përcaktuara në acquis të Bashkimit Evropian, duke krijuar një kuadër rregullator më të qartë dhe më të parashikueshëm për subjektet që veprojnë në treg. Në të njëjtën kohë, ky opsion kontribuon në forcimin e disiplinës së pagesave në marrëdhëniet tregtare, në uljen e rasteve të vonesave në pagesa dhe në përmirësimin e sigurisë juridike për operatorët ekonomikë.

Krahasuar me alternativat e tjera, si ruajtja e kuadrit ekzistues ose harmonizimi i pjesshëm, harmonizimi i plotë siguron arritjen më efektive të objektivave të politikës dhe shmang mospërputhjet ndërmjet legjislacionit kombëtar dhe atij të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, ai konsiderohet si opsioni më i përshtatshëm për realizimin e qëllimit të ndërhyrjes ligjore.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti <u>1</u>	Viti <u>2</u>	Viti <u>3</u>
0	0	0

Shënim shpjegues

- Nuk parashikohet ndikim i drejtpërdrejtë shtesë mbi buxhetin e shtetit.
- Kostot e zbatimit mbulohen nga buxhetet ekzistuese të institucioneve përgjegjëse.
- Çdo nevojë për trajnim dhe përmirësim kapacitetesh do të integrohet në programet ekzistuese institucionale pa krijuar linja të reja financimi.

Për sa i përket kostove, nuk parashikohet ndikim i drejtpërdrejtë financiar mbi buxhetin e shtetit, pasi ndryshimet e propozuara kanë karakter kryesisht normativ dhe do të zbatohen nga institucionet përgjegjëse nëpërmjet strukturave dhe burimeve ekzistuese. Përfitimet e pritshme lidhen me rritjen e sigurisë juridike, përmirësimin e funksionimit të marrëdhënieve tregtare dhe krijimin e kushteve më të favorshme për veprimtarinë ekonomike.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Projektligji është hedhur në platformën e konsultimit publik.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian, Këshilli Ekonomik Kombëtar organizoi në datë 15 qershor 2026 një **takim konsultues për diskutimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe**

ndryshime në ligjin nr. 48/2014 ‘Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare’, i ndryshuar”.

Takimi u mbajt nën drejtimin e z. Martin Kajo, në cilësinë e negociatorit përgjegjës për këtë çështje, dhe kishte për synim diskutimin e projektligjit të hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian dhe transpozimin e plotë të Direktivës 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare”.

Në takim morën pjesë përfaqësues të Shoqatës Shqiptare të Bankave, Bankës së Shqipërisë, Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Projektligji parashikon rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues duke vendosur rregulla më të qarta për afatet e pagesës ndërmjet sipërmarrjeve dhe autoriteteve publike, llogaritjen e kamatëvonesave, procedurat e marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të mallrave e shërbimeve, si dhe mekanizmat për ekzekutimin e detyrimeve të papaguara. Në takim u theksua se ndryshimet e propozuara synojnë forcimin e disiplinës së pagesave, përmirësimin e likuiditetit të sipërmarrjeve dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për aktivitetin ekonomik.

Gjatë diskutimeve, përfaqësuesit e institucioneve dhe grupeve të interesit paraqitën komente dhe rekomandime mbi disa prej dispozitave kryesore të projektligjit.

Përfaqësuesit vlerësuan pozitivisht zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit edhe për subjektet person fizik, duke argumentuar se ky ndryshim përmirëson pozitën e kreditorëve në lidhje me përfitimin e kamatëvonesave ligjore, veçanërisht në kontekstin e praktikës së krijuar pas vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe interpretimit të tyre nga gjykatat shqiptare.

Përmbledhje e komenteve

- U ngrit shqetësimi se individët përfitues të kredive konsumatore dhe hipotekore vijnë të mbeten të patrajtuar plotësisht nga kuadri ligjor në fuqi sa i përket përcaktimit të kamatës ligjore për vonesat në shlyerjen e detyrimeve. Në këtë kuadër, u sugjerua që kjo kategori debitorësh të trajtohet shprehimisht në projektligj ose, alternativisht, të shqyrtohet mundësia e rishikimit të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit”, me qëllim përcaktimin e një norme ligjore interesi për individët. Gjithashtu, u propozua të vlerësohet mundësia e hartimit të një kuadri të posaçëm ligjor për të drejtën e detyrimeve.
- Lidhur me ndryshimet e propozuara në nenin 3 të projektligjit, që përcaktojnë normat referuese të interesit, u evidentua nevoja për saktësim të terminologjisë financiare dhe harmonizim me instrumentet e përdorura nga Banka e Shqipërisë, me qëllim shmangien e paqartësive në interpretim dhe zbatim. Në mënyrë të veçantë, u kërkua një qëndrim teknik nga Banka e Shqipërisë lidhur me normat referuese të parashikuara në draft.
- Gjithashtu, lidhur me normën bazë të interesit për zonën euro, u sugjerua që dispozitat përkatëse të qartësohen më tej ose të parashikohen mekanizma tranzitorë për zbatimin e tyre në të ardhmen. U theksua se përdorimi i alternativave të ndryshme të normave referuese përmes lidhëzës “ose” në dispozitat e projektligjit mund të krijojë paqartësi dhe interpretime të ndryshme në praktikë. Në këtë drejtim, u sugjerua që ligji të përcaktojë në mënyrë të qartë metodologjinë që do të aplikohet dhe rendin e përdorimit të alternativave referuese.

- Një tjetër çështje e diskutuar ishte dispozita e propozuar në nenin 16, e cila parashikon lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nga gjykata brenda 90 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës. U evidentua se ky afat nuk gjen pasqyrim në Kodin e Procedurës Civile dhe, për rrjedhojë, mund të rezultojë i vështirë për t'u zbatuar në praktikë. U theksua gjithashtu se afati i propozuar mbetet relativisht i gjatë për një procedurë që synon njohjen e shpejtë të së drejtës së kreditorit. Në këtë kuadër, u sugjerua që çdo ndryshim i tillë të harmonizohet me dispozitat procedurale në fuqi dhe të shqyrtohet mundësia e rishikimit të afateve procedurale për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

Në përfundim, përfaqësuesit shprehën mbështetjen për çdo iniciativë ligjore që synon krijimin e një kuadri më të qartë dhe të unifikuar për përcaktimin e kamatave ligjore të aplikueshme për të gjitha kategoritë e kreditorëve dhe debitorëve, përfshirë individët.

Pjesëmarrësit mirëpritën nismën për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe theksuan rëndësinë e reflektimit të komenteve teknike të aktorëve të interesit, me qëllim garantimin e një zbatimi sa më efektiv të ligjit dhe harmonizimin e tij me legjislacionin ekzistues.

Projektligji është publikuar gjithashtu, në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike më datë 19.05.2026 dhe ky proces ka përfunduar më datë 16.06.2026. Në regjistër nuk ka patur komente nga palët e interesuara lidhur me projektligjin dhe numri i shikimeve ishte 952.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi? (jo më shumë se 5 rreshta)

Zbatimi i ndryshimeve në ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, të ndryshuar, do të realizohet nga institucionet përgjegjëse ekzistuese, pa krijuar struktura të reja administrative. Institucioni përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e përgjithshëm të zbatimit është ministria përgjegjëse për ekonominë, në bashkëpunim me institucionet e tjera publike që janë palë në transaksione tregtare dhe autoritetet mbikëqyrëse financiare.

Zbatimi praktik i dispozitave do të realizohet nga subjektet private dhe publike në marrëdhëniet e tyre kontraktuale, duke respektuar afatet e pagesave, rregullat për lindjen automatike të kamatëvonesave dhe kushtet për ekzekutimin e detyrimeve. Autoritetet publike do të kenë detyrimin të përshtatin procedurat e tyre të brendshme financiare dhe administrative për të garantuar respektimin e afateve të parashikuara në ligj.

Monitorimi i zbatimit do të bazohet në analizën periodike të treguesve kryesorë, si niveli i vonesave në pagesa në sektorin publik dhe privat, numri i rasteve të kamatëvonesave të aplikuara, si dhe kohëzgjatja mesatare e ekzekutimit të detyrimeve financiare. Në këtë proces do të përfshihen edhe institucionet mbikëqyrëse financiare dhe struktura përgjegjëse për statistikën dhe analizën ekonomike.

Gjithashtu, do të sigurohet bashkëpunim i ngushtë me institucionet e drejtësisë për monitorimin e efikasitetit të procedurave të ekzekutimit të detyrimeve dhe uljen e vonesave gjyqësore. Në rast nevojë, do të propozohen masa shtesë për përmirësimin e zbatimit praktik të ligjit.

Në tërësi, zbatimi dhe monitorimi i këtij ligji do të mbështetet në mekanizmat ekzistues institucionalë, duke synuar një proces të qëndrueshëm, të koordinuar dhe të matshëm në përmirësimin e disiplinës së pagesave në ekonomi.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Click here to enter text. Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar, është miratuar me qëllim krijimin e një kuadri ligjor për luftimin e vonesave në pagesa në transaksionet tregtare ndërmjet ndërmarrjeve dhe ndërmjet ndërmarrjeve dhe autoriteteve publike. Ligji synon të sigurojë pagesa në kohë, të përmirësojë likuiditetin e sipërmarrjeve, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), si dhe të garantojë mbrojtjen e kreditorëve nga pasojat ekonomike të pagesave të vonuara.

Ky ligj ka përafruar pjesërisht legjislacionin shqiptar me kërkesat e Direktivës 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 shkurt 2011, “Për luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare”. Megjithatë, gjatë zbatimit të tij janë identifikuar disa mangësi dhe mospërputhje me *acquis-in* e Bashkimit Evropian, veçanërisht në lidhje me fushën e zbatimit, mekanizmat për mbrojtjen e kreditorëve, trajtimin e klauzolave kontraktore të padrejta dhe garantimin e zbatimit efektiv të të drejtave që rrjedhin nga pagesat e vonuara.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe nga Kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”, është vlerësuar e nevojshme rishikimi i ligjit ekzistues me qëllim harmonizimin e mëtejshëm me Direktivën 2011/7/BE dhe forcimin e sigurisë juridike në marrëdhëniet tregtare. Ndryshimet e propozuara synojnë përmirësimin e disiplinës së pagesave, mbrojtjen më efektive të kreditorëve dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e aktivitetit ekonomik.

“Në zbatim të ligjit nr. 48/2014 ‘Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare’, të ndryshuar, nuk janë miratuar akte nënligjore specifike. Dispozitat e ligjit janë të vetëzbatueshme dhe rregullojnë drejtpërdrejt afatet e pagesës, interesat për vonesën në pagesë, kompensimin për kostot e rikuperimit dhe procedurat për ekzekutimin e detyrimeve monetare. Zbatimi i ligjit mbështetet gjithashtu në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe në normat e interesit të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.”

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Click here to enter text. Përshkruani natyrën e problemit.

Ligji nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare", ka krijuar bazën ligjore për rregullimin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare. Megjithatë, analiza e legjislacionit në fuqi ka evidentuar se ai nuk siguron transpozim të plotë të Direktivës 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 shkurt 2011, për luftimin e vonesave në pagesat në transaksionet tregtare.

1. Transpozim i paplotë dhe jo i saktë i Direktivës 2011/7/BE

Kuadri aktual ligjor nuk pasqyron plotësisht kërkesat e Direktivës së BE-së për pagesat e vonuara. Mangësitë lidhen me përkufizimet bazë të “autoritetit publik”, “sipërmarrjes”, konceptin e kamatëvonesës dhe rregullat për afatet e pagesës. Kjo sjell mospërputhje me *acquis* të BE-së dhe dobëson harmonizimin juridik të sistemit shqiptar me standardet evropiane.

2. Kufizim i gabuar i fushës së zbatimit të ligjit

Ligji aktual ka ngushtuar në mënyrë të pajustificuar fushën e Direktivës duke përjashtuar disa subjekte që duhet të mbroreshin, si shoqëri të rregulluara nga e drejta publike apo sektorë të caktuar si energjia. Kjo bie ndesh me parimin e Direktivës për zbatim të gjerë dhe të njëtrajtshëm, pavarësisht natyrës së kontratës apo sektorit ekonomik.

3. Paqartësi në përkufizime dhe në normat e interesit

Përkufizimet ligjore ekzistuese janë të paplota dhe jo të harmonizuara me praktikën e tregjeve financiare. Ato nuk janë të lidhura në mënyrë të qartë me mekanizmat referues të Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Qendrore Evropiane, duke krijuar pasiguri në llogaritjen e kamatëvonesës dhe në zbatimin e normave të interesit.

4. Mungesë e njohjes së sipërmarrjes si kategori gjithëpërfshirëse

Ligji aktual nuk përfshin në mënyrë të plotë individët tregtarë dhe profesionet e lira, të cilët sipas Direktivës duhet të trajtohen si subjekte të mbrojtura. Kjo krijon pabarazi në trajtim dhe kufizon mbrojtjen ligjore për një pjesë të rëndësishme të operatorëve ekonomikë.

5. Mungesë e automatizmit të plotë të kamatëvonesës

Edhe pse parashikohet në ligj, në praktikë kamatëvonesa nuk zbatohet gjithmonë automatikisht, pasi shpesh kërkon hapa shtesë proceduralë ose ndërhyrje administrative. Kjo dobëson efektin parandalues të ligjit dhe ul disiplinën në respektimin e afateve të pagesave.

6. Afate jo të standardizuara dhe hapësirë për abuzim kontraktor

Ligji lejon afate të ndryshme pagesash dhe në disa raste zgjatje të pajustificuara të tyre, përfshirë vonesa të lidhura me procedura të gjata kolaudimi. Kjo krijon hapësirë për abuzim kontraktor dhe sjell vonesa sistematike në pagesa në treg.

7. Mungesë e mbrojtjes efektive ndaj kushteve të padrejta kontraktore

Kuadri ligjor nuk është mjaftueshëm i qartë në ndalimin dhe pavlefshmërinë e klauzolave abuzive kontraktore, si dhe në parandalimin e manipulimit të afateve të pagesës (p.sh. përmes datës së faturës). Kjo dobëson pozicionin e kreditorëve, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

8. Procedura të ngadalta gjyqësore për ekzekutimin e borxhit

Nuk parashikohen afate të detyrueshme dhe mekanizma të shpejtë për trajtimin e borxheve të pakontestuar dhe lëshimin e urdhrave të ekzekutimit. Kjo sjell vonesa në rikuperimin e detyrimeve, rrit kostot për kreditorët dhe ul efektivitetin e sistemit të drejtësisë.

Identifikoni shkaqet e problemit.

1. Evoluimi i acquis të BE-së pa reflektim të plotë në ligjin vendas

Acquis i Bashkimit Evropian në fushën e pagesave dhe prokurimeve ka evoluar në mënyrë të vazhdueshme, veçanërisht përmes direktivave të reja si 2014/24/BE dhe 2014/25/BE. Megjithatë, kuadri ligjor shqiptar nuk është përditësuar në mënyrë të plotë për të reflektuar këto ndryshime, veçanërisht në përkufizime dhe konceptet bazë. Kjo ka krijuar mospërputhje midis rregullimit kombëtar dhe standardeve të BE-së.

2. Transpozim teknik dhe selektiv i Direktivës 2011/7/BE

Përafrimi i Direktivës 2011/7/BE është realizuar në mënyrë të pjesshme dhe teknike, pa një harmonizim të plotë konceptual. Në disa raste janë bërë devijime në trajtimin e subjekteve, fushës së zbatimit dhe mekanizmave të pagesës, duke krijuar një kuadër ligjor jo tërësisht koherent dhe të plotë.

3. Ndërthurje e paqartë me Kodin Civil

Ekziston një ndërthurje jo e qartë midis ligjit për pagesat e vonuara dhe dispozitave të Kodit Civil, e cila ka sjellë mbivendosje normative dhe mungesë të qartë të hierarkisë së normave. Kjo ka ndikuar në interpretim të ndryshëm të dispozitave dhe pasiguri në zbatim.

4. Praktika kontraktore jo uniforme në treg

Në mungesë të standardizimit të plotë ligjor, palët në marrëdhëniet tregtare kanë zhvilluar praktika të ndryshme kontraktore, duke përfshirë klauzola jo të njëtrajtshme për afatet e pagesës dhe kushtet e ekzekutimit. Kjo i ka dhënë debitorëve hapësirë të gjerë negociimi dhe ka dobësuar disiplinën kontraktore.

5. Dobësi në mekanizmat e zbatimit dhe ekzekutimit

Sistemi aktual i zbatimit të detyrimeve nuk garanton gjithmonë rikuperim të shpejtë dhe efektiv të borxheve. Mungesa e afateve të forta procedurale dhe mekanizmave të shpejtë gjyqësorë për borxhet e pakontestuar ka sjellë vonesa në ekzekutimin e detyrimeve dhe rritje të kostove për kreditorët.

6. Mungesë e harmonizimit me zhvillimet financiare dhe institucionale

Kuadri aktual i normave të interesit dhe referencave financiare nuk është plotësisht i lidhur me zhvillimet e Bankës së Shqipërisë, Bankës Qendrore Evropiane dhe tregjeve financiare. Kjo ka krijuar pasiguri në përcaktimin e kamatëvonesës dhe mungesë të reflektimit të dinamikës reale të tregut.

Problematikat e identifikuara në kuadrin e ligjit nr. 48/2014 janë kryesisht rregullatore, pasi lidhen me mangësi në hartimin, përmbajtjen dhe harmonizimin e normave ligjore me Direktivën 2011/7/BE dhe me zhvillimet e *acquis* të Bashkimit Evropian. Këto mangësi shfaqen në përkufizime të paplota ligjore, fushë të kufizuar zbatimi, mungesë të mekanizmave të automatizuar për kamatëvonesën, rregulla jo të standardizuara për afatet e pagesës, si dhe mungesë të mbrojtjes efektive ndaj praktikave kontraktore abuzive.

Në të njëjtën kohë, ekzistojnë edhe problematika jorregullatore, të cilat lidhen me mënyrën e funksionimit të tregut dhe zbatimit praktik të ligjit. Këto përfshijnë praktika kontraktore jo uniforme ndërmjet palëve, hapësira të gjerë negociimi për debitorët, zbatim jo të njëtrajtshëm të detyrimeve kontraktore dhe dobësi në funksionimin e mekanizmave gjyqësorë dhe të ekzekutimit të detyrimeve. Gjithashtu, mungesa e lidhjes së plotë të normave të interesit me tregjet financiare dhe institucionet referuese krijon pasiguri në praktikën e zbatimit.

Problemi prek një gamë të gjerë aktorësh ekonomikë dhe institucionalë:

2. Qeveria dhe institucionet publike, të cilat kanë detyrimin për respektimin e afateve të pagesave dhe zbatimin e disiplinës financiare në transaksionet tregtare;
3. Operatorët ekonomikë, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), të cilat preken drejtpërdrejt nga vonesat në pagesa, mungesa e likuiditetit dhe kostot shtesë financiare;
4. Kreditorët dhe furnitorët tregtarë, të cilët përballen me rrezikun e mosmarrjes në kohë të pagesave dhe vështirësi në rikuperimin e borxheve;
5. Sistemi gjyqësor dhe organet e ekzekutimit, të cilat trajtojnë mosmarrëveshjet dhe procedurat për rikuperimin e detyrimeve të papaguara;
6. Qytetarët dhe konsumatorët, të cilët ndikohen indirekt përmes stabilitetit të tregut, çmimeve, punësimit dhe funksionimit të përgjithshëm të ekonomisë.

Problemi ka shtrirje të gjerë dhe sistematike në ekonominë shqiptare. Ai nuk kufizohet në një sektor të vetëm, por shfaqet në të gjitha marrëdhëniet tregtare ndërmjet bizneseve, si dhe ndërmjet bizneseve dhe autoriteteve publike.

Vonesat në pagesa dhe mungesa e një kuadri plotësisht të harmonizuar me BE-në ndikojnë në mënyrë të vazhdueshme në funksionimin e zinxhirëve të furnizimit, në sektorët me volum të lartë transaksionesh dhe në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik. Efekti është veçanërisht i ndjeshëm te NVM-të, të cilat kanë më pak kapacitet financiar për të përballuar vonesat në pagesa dhe varësi më të madhe nga likuiditeti i shpejtë.

Në aspekt institucional, problemi shtrihet edhe në sistemin gjyqësor dhe administrativ, ku procedurat për rikuperimin e borxheve shpesh janë të gjata dhe jo të unifikuara.

7. Përshkruani shtrirjen e problemit.

Pagesat e vonuara në transaksionet tregtare vijojnë të përbëjnë një problem për funksionimin normal të aktivitetit ekonomik, duke ndikuar negativisht në likuiditetin e ndërmarrjeve, në aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet financiare dhe në konkurrueshmërinë e tyre në treg. Pasojat e pagesave të vonuara janë veçanërisht të ndjeshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), të cilat kanë burime më të kufizuara financiare dhe varen në masë më të madhe nga arkëtimi në kohë i detyrimeve.

Analiza e kuadrit ligjor ekzistues ka evidentuar se disa dispozita të ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar, nuk sigurojnë një përafrim të plotë me kërkesat e Direktivës 2011/7/BE. Gjithashtu, janë identifikuar boshllëqe dhe paqartësi në lidhje me zbatimin e disa mekanizmave mbrojtës për kreditorët, trajtimin e kushteve kontraktore dhe praktikave që mund të rezultojnë dukshëm të padrejta, si dhe me garantimin e mjeteve efektive për kërkimin e të drejtave në rast vonese pagese.

Mospërputhjet me *acquis-in* e Bashkimit Evropian ndikojnë negativisht në nivelin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian. Për këtë arsye, është e nevojshme ndërhyrja ligjore për të përmirësuar kuadrin ekzistues, për të garantuar mbrojtje më efektive të kreditorëve dhe për të forcuar disiplinën e pagesave në marrëdhëniet tregtare.

Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.

Grupi kryesor i prekur nga problematika e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare janë bizneset, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), të cilat varen në masë të konsiderueshme nga arkëtimi në kohë i pagesave për të siguruar likuiditetin e nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të tyre. Vonesat në pagesa mund të sjellin vështirësi financiare, rritje të kostove operative dhe kufizim të mundësive për investime dhe zhvillim.

Problemi prek gjithashtu autoritetet publike, në rastet kur ato janë palë në transaksione tregtare, pasi kuadri ligjor përcakton detyrime lidhur me respektimin e afateve të pagesës dhe garantimin e disiplinës financiare në përdorimin e fondeve publike. Për më tepër, harmonizimi i legjislacionit me *acquis-in* e Bashkimit Evropian përbën një detyrim institucional në kuadër të procesit të integritimit evropian.

Shoqëria civile dhe organizatat që përfaqësojnë interesat e biznesit preken në mënyrë indirekte përmes rolit të tyre në promovimin e praktikave të drejta tregtare dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit. Gjithashtu, qytetarët ndikohen në mënyrë të tërthortë nga efektet që pagesat e vonuara kanë mbi veprimtarinë ekonomike, konkurrueshmërinë e bizneseve dhe ruajtjen e vendeve të punës. Përmirësimi i disiplinës së pagesave pritet të kontribuojë në një mjedis ekonomik më të qëndrueshëm dhe më të favorshëm për zhvillimin e aktivitetit tregtar.

Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.

Po, problemi mund të trajtohet përmes një ndryshimi të politikave dhe kuadrit ligjor ekzistues. Analiza e legjislacionit në fuqi ka evidentuar se disa dispozita të ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në

detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar, nuk sigurojnë një përafrim të plotë me kërkesat e Direktivës 2011/7/BE dhe nuk ofrojnë në të gjitha rastet mekanizma të mjaftueshëm për mbrojtjen efektive të kreditorëve nga vonesat në pagesa.

Ndërhyrja përmes ndryshimeve ligjore synon të përmirësojë qartësinë e dispozitave ekzistuese, të forcojë mekanizmat mbrojtës në favor të kreditorëve, të garantojë zbatimin më efektiv të të drejtave që rrjedhin nga pagesat e vonuara dhe të harmonizojë më tej legjislacionin kombëtar me *acquis-in* e Bashkimit Evropian. Kjo pritet të kontribuojë në rritjen e disiplinës së pagesave në transaksionet tregtare, përmirësimin e likuiditetit të ndërmarrjeve dhe krijimin e një mjedisi më të sigurt e më të parashikueshëm për zhvillimin e aktivitetit ekonomik.

Për rrjedhojë, ndryshimi i politikës nëpërmjet ndërhyrjes legjislative vlerësohet si mjeti më i përshtatshëm dhe më efektiv për adresimin e problematikave të identifikuara dhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhijë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhijjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhijje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme me qëllim sigurimin e transpozimit të plotë të Direktivës 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator ekzistues në fushën e pagesave në transaksionet tregtare.

Analiza e ligjit në fuqi nr. 48/2014 ka evidentuar se, pavarësisht krijimit të bazës ligjore për luftimin e pagesave të vonuara, ai nuk reflekton në mënyrë të plotë të gjitha kërkesat e Direktivës, veçanërisht në lidhje me afatet maksimale të pagesës, mekanizmin automatik të kamatëvonesës, kompensimin e kostove të rikuperimit të borxhit dhe forcimin e mjeteve juridike për kreditorët.

Për këtë arsye, ndërhyrja është e nevojshme për të:

- garantuar përputhshmërinë e plotë të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e tregut të brendshëm;
- përmirësuar disiplinën e pagesave në transaksionet tregtare;
- rritur sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë në marrëdhëniet kontraktore;
- mbrojtur më efektivisht operatorët ekonomikë, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, nga efektet negative të vonesave në pagesa.

Ndërhyrja gjithashtu synon të adresojë ndikimet ekonomike që burojnë nga vonesat sistematike në pagesa, të cilat cenojnë likuiditetin e bizneseve, rrisin kostot e financimit dhe ndikojnë negativisht në stabilitetin e tregut.

Në këtë kontekst ndërhyrja e qeverisë konsiderohet të domosdoshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit të pagesave, për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të përmbushur angazhimet e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.

Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria përmes kësaj ndërhijjeje.

Përmes kësaj ndërhijjeje legjislative, qeveria synon të adresojë në mënyrë të drejtpërdrejtë problemin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare, duke forcuar kuadrin ligjor ekzistues dhe duke siguruar transpozimin e plotë të Direktivës 2011/7/BE.

Në mënyrë të veçantë, ndërhyrja synon të:

- reduktojë praktikën e pagesave me vonesë në marrëdhëniet kontraktore ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe ndërmjet këtyre të fundit dhe autoriteteve publike;
- vendosë rregulla më të qarta dhe më të detyrueshme për afatet e pagesave;
- garantojë aplikimin automatik të kamatëvonesës dhe kompensimit të kostove të rikuperimit të borxhit;
- rrisë sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë në marrëdhëniet tregtare;
- përmirësojë mbrojtjen e kreditorëve, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), të cilat janë më të ekspozuara ndaj problemeve të likuiditetit;
- rrisë disiplinën financiare të institucioneve publike dhe operatorëve ekonomikë në respektimin e afateve kontraktuale të pagesës.

Në një këndvështrim më të gjerë, ndërhyrja synon të përmirësojë funksionimin e tregut, të forcojë klimën e biznesit dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik përmes rritjes së besimit në marrëdhëniet kontraktore dhe uljes së kostove financiare të shkaktuara nga vonesat në pagesa.

Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.

Trajtimi i problematikës së pagesave të vonuara në transaksionet tregtare kërkon një ndërhyrje të plotë dhe të strukturuar të qeverisë, në mënyrë që të sigurohet transpozimi i plotë i Direktivës 2011/7/BE dhe përmirësimi i kuadrit ekzistues ligjor.

Shkalla e ndërhyrjes vlerësohet si e plotë, pasi problematika nuk mund të adresohet përmes masave administrative të pjesshme apo udhëzimeve të përgjithshme, por kërkon ndryshime thelbësore në dispozitat ligjore që rregullojnë afatet e pagesës, kamatëvonesat, të drejtat e kreditorëve dhe mekanizmat e zbatimit.

Ndërhyrja përfshin:

- sigurimin e përputhshmërisë së plotë me acquis të Bashkimit Evropian;
- përcaktimin e qartë të rregullave detyruese për afatet e pagesës në transaksionet tregtare;
- forcimin e mekanizmave ligjorë për zbatimin e të drejtave të kreditorëve;
- përmirësimin e qartësisë dhe koherencës së kuadrit ligjor ekzistues.

Në nivel institucional, ndërhyrja kërkon një angazhim të moderuar të strukturave ekzistuese përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit, kryesisht në drejtim të përditësimit të procedurave të punës dhe forcimit të kapaciteteve zbatuese, pa nevojën e krijimit të institucioneve të reja apo rritjes së ndjeshme të strukturës administrative.

Në përfundim, ndërhyrja konsiderohet e domosdoshme, duke synuar rregullim të plotë të problematikës përmes harmonizimit të kuadrit ekzistues me standardet e Bashkimit Evropian.

Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.

Nisma lidhet me prioritetet e **Programit të Qeverisë** në drejtim të përmirësimit të klimës së biznesit, forcimit të disiplinës financiare dhe rritjes së konkurrueshmërisë së ekonomisë. Përmes vendosjes së afateve më të rrepta të pagesës, kamatëvonesës automatike dhe mbrojtjes së kreditorëve, projektligji synon të reduktojë vonesat në pagesa që ndikojnë negativisht në likuiditetin e sipërmarrjeve, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë mënyrë, nisma kontribuon në objektivin qeveritar për një ekonomi më të formalizuar, më të parashikueshme dhe më të qëndrueshme financiarisht.

Nisma përbën një masë të drejtpërdrejtë të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian, konkretisht me Direktivën 2011/7/BE për luftimin e pagesave të vonuara. Ajo adreson boshllëqet e identifikuara në transpozimin ekzistues dhe siguron harmonizim me parimet e tregut të brendshëm të BE-së, si siguria

juridike, barazia ndërmjet subjekteve ekonomike dhe mbrojtja e konkurrencës së ndershme. Në këtë kuadër, nisma kontribuon në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në BE, veçanërisht në fushën e të drejtës së shoqërive dhe politikës ekonomike e financiare.

Nisma mbështet objektivat e **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim** në drejtim të rritjes së qëndrueshme ekonomike, forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmirësimit të mjedisit të biznesit. Duke reduktuar vonesat në pagesa dhe duke rritur sigurinë e marrëdhënieve kontraktore, ajo kontribuon në përmirësimin e funksionimit të tregut dhe në rritjen e besimit ndërmjet aktorëve ekonomikë. Gjithashtu, nisma ndikon pozitivisht në rritjen e efikasitetit të sektorit privat dhe në rritjen e investimeve vendase dhe të huaja.

Strategjia për përmirësimin e klimës së biznesit dhe investimeve

Nisma lidhet drejtpërdrejt me objektivat e përmirësimit të klimës së biznesit, duke adresuar një nga problemet kryesore të identifikuara nga bizneset: vonesat në pagesa nga partnerët tregtarë dhe nga sektori publik. Përmes vendosjes së afateve të detyrueshme, kufizimit të praktikave kontraktore abuzive dhe forcimit të mekanizmit të kamatëvonesës automatike, nisma synon të rrisë likuiditetin në ekonomi dhe të përmirësojë parashikueshmërinë e flukseve financiare për bizneset.

Strategjia për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME)

Nisma ka ndikim të drejtpërdrejtë në mbështetjen e SME-ve, të cilat janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të vonesave në pagesa dhe mungesës së likuiditetit. Duke forcuar të drejtën për kamatëvonesë automatike dhe duke kufizuar afatet e pagesës, projektligji rrit mbrojtjen financiare të këtyre subjekteve dhe përmirëson aftësinë e tyre për të operuar në mënyrë të qëndrueshme. Kjo kontribuon në zhvillimin e një sektori SME më konkurrues dhe më rezistent ndaj riskut të tregut.

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (PFM)

Nisma mbështet objektivat e menaxhimit të financave publike duke përmirësuar disiplinën e pagesave nga autoritetet publike dhe duke reduktuar detyrimet e prapambetura (arrears). Vendosja e afateve të detyrueshme për pagesat dhe kufizimi i zgjatjes së procedurave administrative rrit transparencën dhe përgjegjshmërinë fiskale. Gjithashtu, forcon parashikueshmërinë buxhetore dhe ul rrezikun e akumulimit të detyrimeve të fshehura.

Ndërhyrja për transpozimin e plotë të Direktivës 2011/7/BE në ligjin “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare” mbështet një sërë objektivash strategjike të nivelit të lartë të qeverisë, veçanërisht në fushën e zhvillimit ekonomik, përmirësimit të klimës së biznesit dhe procesit të integritetit evropian.

Së pari, ndërhyrja kontribuon në forcimin e ekonomisë së tregut dhe rritjen e konkurrueshmërisë, duke përmirësuar disiplinën e pagesave dhe duke reduktuar vonesat në transaksionet tregtare. Kjo krijon një mjedis më të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit privat dhe rritjen e investimeve.

Së dyti, ndërhyrja mbështet objektivin e qeverisë për përmirësimin e klimës së biznesit dhe lehtësimin e të bërit biznes, përmes rritjes së sigurisë juridike, parashikueshmërisë kontraktore dhe uljes së kostove financiare që rrjedhin nga vonesat në pagesa, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Së treti, ndërhyrja është në përputhje të drejtpërdrejtë me objektivin strategjik të integritetit në Bashkimin Evropian, pasi siguron harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së në fushën e tregut të brendshëm dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i përafrimit ligjor.

Së katërti, ndërhyrja kontribuon në forcimin e qeverisjes ekonomike dhe disiplinës fiskale, duke përmirësuar respektimin e afateve të pagesave nga institucionet publike dhe duke ulur kostot që lidhen me kamatëvonesat dhe detyrimet e prapambetura.

Në tërësi, ndërhyrja mbështet objektivat strategjike të qeverisë për një ekonomi më të qëndrueshme, më konkurruese dhe të integruar në tregun evropian, duke rritur efektivitetin e kuadrit ligjor dhe besimin e aktorëve ekonomikë në sistemin juridik.

Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

1. Është miratuar Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, i cili ka vendosur bazën ligjore për rregullimin e afateve të pagesave, kamatëvonesave dhe të drejtave të kreditorëve në transaksionet tregtare.

Zbatimi i ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, të ndryshuar, realizohet kryesisht nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet subjekteve private dhe ndërmjet subjekteve private dhe autoriteteve publike. Ligji përcakton afatet maksimale të pagesës, të drejtën e kreditorit për të kërkuar interes për vonesën në pagesë dhe kompensim për kostot e rikuperimit të detyrimit, pa qenë e nevojshme një kërkesë paraprake ndaj debitorit.

Në praktikë, përgjegjësia kryesore për zbatimin e ligjit bie mbi palët në transaksionet tregtare, të cilat duhet të respektojnë afatet dhe detyrimet e përcaktuara në ligj. Në rast mosmarrëveshjeje ose mosshlyerjeje të detyrimit, kreditori mund t'u drejtohet organeve gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe për nxjerrjen e titullit ekzekutiv sipas legjislacionit procedural në fuqi.

Institucionet kryesore të përfshira në zbatimin e ligjit janë:

Gjykatat, të cilat shqyrtojnë mosmarrëveshjet që lindin nga transaksionet tregtare dhe vendosin mbi kërkesat për detyrimet e papaguara, interesat dhe kostot përkatëse;

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor, publik ose privat, i cili realizon ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë në rastet kur debitori nuk përmbush vullnetarisht detyrimin;

Autoritetet publike, në rastet kur janë palë në transaksione tregtare dhe kanë detyrimin të respektojnë afatet ligjore të pagesës;

Banka e Shqipërisë, e cila përcakton normën bazë të interesit që shërben si element referues për llogaritjen e interesit për pagesat e vonuara sipas ligjit.

Janë realizuar vlerësime dhe analiza periodike mbi efektivitetin e kuadrit ligjor ekzistues, të cilat kanë evidentuar nevojën për përmirësime dhe harmonizim të mëtejshëm me Direktivën 2011/7/BE. Nevoja për përmirësimin e kuadrit ligjor është evidentuar në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian, përmes vlerësimeve të kryera gjatë procesit të harmonizimit të legjislacionit dhe analizave të përputhshmërisë së ligjit nr. 48/2014 me Direktivën 2011/7/BE. Këto vlerësime kanë identifikuar mospërputhje dhe boshllëqe në transpozimin e disa dispozitave të Direktivës, veçanërisht në lidhje me afatet e pagesës, kompensimin e kostove të rikuperimit të borxhit dhe mbrojtjen nga kushtet kontraktuale haptazi të padrejta, duke evidentuar nevojën për ndërhyrje ligjore me qëllim harmonizimin e plotë të kuadrit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian.

Janë ndërmarrë masa informuese dhe udhëzuese nga institucionet përkatëse për rritjen e ndërgjegjësimit mbi respektimin e afateve të pagesave dhe forcimin e disiplinës financiare në treg.

Është realizuar analiza e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së në fushën e pagesave të vonuara, e cila ka identifikuar boshllëqe në kuadrin aktual ligjor dhe nevojën për ndërhyrje rregullatore.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian, është punuar në identifikimin e masave të nevojshme për përafrimin e plotë me Direktivën 2011/7/BE.

Kuadri i politikave fiskale në fuqi, përfshirë Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030 dhe Deklaratën e Riskeve Fiskale 2024, evidenton nevojën për forcimin e disiplinës fiskale, përmirësimin e menaxhimit të detyrimeve të prapambetura dhe rritjen e efektivitetit të sistemit të pagesave publike. Në veçanti, dokumentet strategjike theksojnë rëndësinë e reduktimit të detyrimeve të prapambetura të qeverisë

dhe përmirësimit të kontrollit të angazhimeve buxhetore, me qëllim ruajtjen e stabilitetit fiskal dhe përmirësimin e likuiditetit të ekonomisë.

Në këtë kontekst, ndërhyrja në ligjin për pagesat e vonuara kontribuon në adresimin e këtyre sfidave, duke forcuar rregullat për respektimin e afateve të pagesës dhe duke reduktuar efektet negative të vonesave në transaksionet tregtare.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
 - *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
 - *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*
1. Forcimi i sigurisë juridike dhe harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare.
 2. Përmirësimi i qartësisë dhe uniformitetit të kuadrit rregullator përmes plotësimit dhe standardizimit të përkufizimeve që lidhen me subjektet, transaksionet tregtare dhe detyrimet e pagesës, me qëllim zbatimin e njëtrajtshëm nga të gjitha palët e interesuara.
 3. Rritja e sigurisë juridike në marrëdhëniet tregtare, përmes eliminimit të paqartësive dhe përcaktimit të qartë të të drejtave dhe detyrimeve të palëve.
 4. Përmirësimi i likuiditetit të sipërmarrjeve, veçanërisht i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes reduktimit të ndikimit negativ të pagesave të vonuara.
 5. Reduktimi me të paktën 20% i numrit të rasteve të raportuara të pagesave të vonuara në transaksionet ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe institucioneve publike, përmes forcimit të zbatimit të afateve ligjore të pagesës, deri në fund të vitit 2028.
 6. Rritja në të paktën 85% e nivelit të respektimit të afateve kontraktuale të pagesave nga institucionet publike, bazuar në monitorimet institucionale dhe raportimet periodike, deri në fund të vitit 2029.
 7. Përmirësimi, i likuiditetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), i matur përmes uljes së nevojës për financim afatshkurtër të jashtëm si pasojë e vonesave në pagesa deri në fund të vitit 2029.
 8. Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe administrativë për zbatimin e kamatëvonesës automatike dhe kompensimit të kostove të rikuperimit, duke siguruar zbatim uniform nga të gjitha institucionet publike, , deri në fund të vitit 2028.
 9. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit dhe zbatimit të rregullave për pagesat në kohë në sektorin publik dhe privat, përmes aktiviteteve informuese, udhëzuese dhe monitoruese institucionale, deri në fund të vitit 2029.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*

- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Në kuadër të adresimit të problematikave të evidentuara, janë identifikuar disa opsione kryesore politikash:

Për adresimin e problematikave të identifikuar janë shqyrtuar katër opsione politike, përfshirë një opsion jorregullator.

Opsioni 0: Status quo (mosndërhyrja)

Ky opsion konsiston në ruajtjen e kuadrit ligjor ekzistues pa ndërhyrje ligjore apo administrative. Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, të ndryshuar, do të vazhdon të zbatohet në formën aktuale.

Avantazhet

- Nuk krijon kosto shtesë ligjore, administrative apo financiare.
- Nuk kërkon ndryshime në procedurat ekzistuese të institucioneve publike dhe operatorëve ekonomikë.
- Nuk kërkon trajnime apo masa përshtatëse.

Disavantazhet

- Nuk adreson mangësitë e identifikuar në ligjin nr. 48/2014.
- Nuk siguron harmonizimin e plotë me Direktivën 2011/7/BE.
- Vazhdon pasiguria juridike dhe paqartësitë në interpretimin e dispozitave.
- Nuk përmirëson mbrojtjen e kreditorëve dhe të NVM-ve.
- Ndikon negativisht në përmbushjen e detyrimeve të integritetit evropian.

Opsioni 1: Masa jorregullatore

Ky opsion parashikon marrjen e masave administrative dhe informuese pa ndryshuar kuadrin ligjor ekzistues. Masat mund të përfshijnë hartimin e udhëzimeve orientuese, aktivitete ndërgjegjësuere për biznesin dhe institucionet publike, si dhe trajnime për subjektet e përfshira në zbatimin e ligjit.

Ky opsion mund të kontribuojë në rritjen e njohjes së detyrimeve ligjore ekzistuese dhe në përmirësimin e praktikave të pagesave. Megjithatë, ai nuk eliminon mangësitë e kuadrit ligjor aktual dhe nuk siguron harmonizimin e nevojshëm me *acquis-in* e Bashkimit Evropian.

Avantazhet

- Kosto relativisht e ulët financiare dhe administrative.
- Mund të zbatohet në afat të shkurtër.
- Kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimin dhe njohjes së detyrimeve ligjore ekzistuese.
- Mund të sjellë përmirësime të kufizuara në zbatimin praktik të ligjit.

Disavantazhet

- Nuk eliminon mangësitë e kuadrit ligjor ekzistues.
- Nuk siguron harmonizim me Direktivën 2011/7/BE.
- Nuk zgjidh problemet që lidhen me përkufizimet, afatet e pagesës dhe mekanizmat e mbrojtjes së kreditorëve.
- Efektiviteti i masave varet nga niveli i bashkëpunimit vullnetar të aktorëve të përfshirë.

Opsioni 2: Ndryshime të pjesshme të ligjit, harmonizim i pjesshëm i Direktivës së BE-së

Ky option parashikon ndërhyrje të kufizuara në disa dispozita të ligjit aktual, kryesisht ato që lidhen me afatet e pagesës, kamatëvonesat dhe elemente të caktuara procedurale.

Ky option do të mundësonte adresimin e disa problematikave të identifikuara dhe do të sillte përmirësime të pjesshme në funksionimin e kuadrit ligjor ekzistues. Megjithatë, ai nuk do të garantonte harmonizim të plotë me Direktivën 2011/7/BE dhe nuk do të adresonte në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha mangësitë e evidentuara.

Avantazhet

- Kosto më e ulët krahasuar me reformimin e plotë të ligjit.
- Adreson disa nga problematikat më urgjente.
- Mund të zbatohet më shpejt sesa një reformë e plotë.

Disavantazhet

- Siguron vetëm harmonizim të pjesshëm me *acquis-in* e Bashkimit Evropian.
- Lë të pazgjidhura një pjesë të mangësive strukturore të ligjit.
- Mund të krijojë fragmentim të mëtejshëm të kuadrit ligjor.
- Nuk garanton mbrojtje të plotë dhe efektive për kreditorët.

Opsioni 3: Ndryshime të ligjit dhe transpozim i plotë i Direktivës 2011/7/BE

Ky option parashikon rishikimin e plotë të ligjit nr. 48/2014 me qëllim harmonizimin e plotë me Direktivën 2011/7/BE. Ndryshimet e propozuara përfshijnë qartësimin dhe zgjerimin e përkufizimeve ligjore, përmirësimin e rregullimit të afateve të pagesës dhe kamatëvonesave, forcimin e mbrojtjes së kreditorëve, si dhe përmirësimin e mekanizmave për mbledhjen dhe ekzekutimin e detyrimeve të papaguara.

Ky option adreson në mënyrë të plotë problematikat e identifikuara, siguron përputhshmëri të plotë me *acquis-in* e Bashkimit Evropian dhe kontribuon në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Avantazhet

- Siguron harmonizim të plotë me *acquis-in* e Bashkimit Evropian.
- Përmbush detyrimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian.
- Rrit sigurinë juridike dhe qartësinë e kuadrit ligjor.
- Forcon mbrojtjen e kreditorëve dhe veçanërisht të NVM-ve.
- Përmirëson disiplinën e pagesave dhe likuiditetin e sipërmarrjeve.
- Kontribuon në përmirësimin e klimës së biznesit dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë.

Disavantazhet

- Kërkon përshtatjen e institucioneve publike dhe operatorëve ekonomikë me dispozitat e reja.
- Mund të kërkojë aktivitete trajnuese dhe informuese gjatë fazës fillestare të zbatimit.
- Shoqërohet me kosto administrative të kufizuara për zbatimin dhe monitorimin fillestar.

Opsioni i preferuar

Pas vlerësimit të alternativave të mësipërme, opsioni 3 vlerësohet si alternativa më e përshtatshme, pasi është i vetmi option që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse problematikat e identifikuara, siguron harmonizimin e plotë me Direktivën 2011/7/BE, përmbush detyrimet e integritetit evropian dhe krijon një kuadër më efektiv për mbrojtjen e kreditorëve dhe funksionimin e tregut.

Opsionet e mësipërme janë identifikuar në bazë të analizës së problematikave të evidentuara në ligjin nr. 48/2014, shkallës së harmonizimit me Direktivën 2011/7/BE, objektivave të politikës së propozuar dhe ndikimit të mundshëm të secilës alternativë mbi biznesin, administratën publike dhe procesin e integritetit evropian. Analiza ka marrë në konsideratë si alternativat jorregullatore ashtu edhe ato rregullatore, duke vlerësuar kostot, përfitimet dhe efektivitetin e secilit opsion në arritjen e objektivave të politikës. Pas këtij vlerësimi, opsioni i ndryshimeve të plotë të ligjit dhe transpozimit të plotë të Direktivës 2011/7/BE është identifikuar si alternativa më e përshtatshme.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Zbatimi i opsionit të preferuar (harmonizimi i plotë me Direktivën 2011/7/BE) prek këto grupe kryesore:

1. **Qeveria dhe institucionet publike**
2. **Operatorët ekonomikë (bizneset), veçanërisht NVM-të**
3. **Institucionet gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit**
4. **Shoqëria në përgjithësi (indirekt)**

2. Ndikimet e drejtpërdrejta të analizuara në mënyrë cilësore:

Qeveria / institucionet publike:

- Ndikime administrative dhe institucionale
- Forcim i përgjegjësisë së autoriteteve publike për respektimin e afateve ligjore të pagesave.
- Nevojë për përmirësimin e planifikimit financiar dhe menaxhimit të detyrimeve kontraktore.
- Rritje e disiplinës buxhetore dhe e monitorimit të proceseve të pagesave.
- Kufizim i praktikave që mund të vonojnë artificialisht pagesat ndaj operatorëve ekonomikë.
- Rritje e ekspozimit ndaj pagesës së kamatëvonesave në rast mosrespektimi të afateve ligjore.
- Ndikim financiar për institucionet publike
- Mund të rriten kostot financiare në rastet kur autoritetet publike nuk respektojnë afatet ligjore, për shkak të detyrimit për të paguar kamatëvonesa dhe kostot e rikuperimit të borxhit.
- Përmirësim i disiplinës financiare dhe procedurave të brendshme të pagesave.
- Nevojë për forcim të monitorimit dhe kontrollit të detyrimeve financiare.

Bizneset (NVM dhe të tjera):

- Forcim i pozitës së kreditorit në procesin e rikuperimit të detyrimeve të papaguara përmes kamatëvonesës automatike dhe përsheptimit të procedurave të ekzekutimit.
- Forcim i mbrojtjes së kreditorëve dhe përmirësim i mekanizmave për rikuperimin e detyrimeve të papaguara.
- Rritje e mundësive të pjesëmarrjes së NVM-ve në marrëdhënie kontraktore me autoritetet publike për shkak të uljes së rrezikut të vonesave në pagesa.
- Përmirësim i likuiditetit dhe fluksit të parasë.
- Rritje e sigurisë juridike në marrëdhëniet kontraktuale.
- Reduktim i rrezikut që lidhet me pagesat e vonuara dhe ulje e nevojës për financim afatshkurtër të shkaktuar nga mungesa e likuiditetit.

Sistemi gjyqësor / zbatimi:

Projektligji mund të ketë ndikim në veprimtarinë e institucioneve gjyqësore dhe të organeve përgjegjëse për ekzekutimin e detyrimeve, për shkak të forcimit të të drejtave të kreditorëve dhe qartësisht të rregullave që lidhen me pagesat e vonuara në transaksionet tregtare.

Në periudhën fillestare të zbatimit mund të evidentohet një rritje e kufizuar e numrit të kërkesave për ekzekutimin e detyrimeve financiare, përfshirë pretendimet për kamatëvonesa dhe kompensimin e kostove të rikuperimit të borxhit, pasi subjektet ekonomike do të kenë një bazë ligjore më të qartë për ushtrimin e të drejtave të tyre. Megjithatë, kjo rritje nuk pritet të jetë e tillë që të kërkojë krijimin e strukturave të reja apo burime shtesë të konsiderueshme për sistemin gjyqësor.

Në afat të mesëm dhe afatgjatë, pritet që qartësimi i dispozitave ligjore dhe harmonizimi i tyre me standardet e Bashkimit Evropian të kontribuojnë në rritjen e disiplinës së pagesave dhe respektimin më të mirë të detyrimeve kontraktore nga palët. Si pasojë, mund të reduktohet numri i mosmarrëveshjeve që lidhen me vonesat në pagesa, interpretimin e të drejtave të kreditorëve dhe llogaritjen e detyrimeve për kamatëvonesa.

Për shkak se ndryshimet e propozuara nuk krijojnë procedura të reja gjyqësore dhe nuk transferojnë kompetenca shtesë tek gjykatat apo organet e ekzekutimit, nuk parashikohet ndikim i rëndësishëm administrativ ose financiar mbi kapacitetet ekzistuese të sistemit gjyqësor. Megjithatë, efektet e zbatimit të ligjit do të monitorohen në kuadër të vlerësimeve periodike të legjislacionit, me qëllim identifikimin e çdo nevojë për masa shtesë përmirësuese.

b) Ndikimet të vlerësuara në mënyrë sasiore

- Ulje e pritshme e kostove të financimit afatshkurtër për bizneset (veçanërisht NVM-të), si rezultat i përmirësimit të likuiditetit.
- Reduktim gradual i rasteve të pagesave të vonuara (parashikuar në afat 2–3 vjeçar me ~15–20%).
- Ulje e kostove të lidhura me ndjekjen gjyqësore të borxheve (në afat të mesëm).

c) Ndikimet monetare

Buxheti i shtetit: kosto minimale për zbatim administrativ (trajnim, përditësim procedurash), e përballeshme brenda buxheteve ekzistuese.

Bizneset: kursime indirekte nga reduktimi i kamatëvonesave dhe kostove të huamarrjes afatshkurtër (nuk mund të përcaktohet saktë në lekë pa të dhëna financiare të detajuara sektoriale).

Nuk është kryer një analizë sasiore e kostove dhe përfitimeve, pasi mungojnë të dhënat e nevojshme statistikore dhe financiare që do të mundësonin një vlerësim të besueshëm të ndikimeve në terma monetarë. Në veçanti, nuk disponohen të dhëna të plota mbi numrin e rasteve të pagesave të vonuara, vlerën e kamatëvonesave që mund të aplikohen në të ardhmen apo kostot e mundshme të rikuperimit të borxheve që do të mund të përfitoheshin nga subjektet private.

Nga analiza e kryer rezulton se zbatimi i projektligjit nuk pritet të sjellë kosto shtesë të drejtpërdrejta për buxhetin e shtetit. Institucionet publike do të vijojnë të zbatojnë detyrimet e tyre nëpërmjet strukturave ekzistuese administrative dhe procedurave aktuale të menaxhimit financiar. Gjithashtu, nuk është identifikuar nevoja për krijimin e sistemeve të reja administrative apo për shtim të personelit si rezultat i hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara.

Sa i përket ndikimit mbi institucionet publike, projektligji synon të përforcojë respektimin e afateve të pagesave dhe të rrisë sigurinë juridike në marrëdhëniet kontraktore, pa ndryshuar mekanizmat ekzistues të planifikimit buxhetor dhe të ekzekutimit të pagesave. Për rrjedhojë, nuk pritet një ndikim i rëndësishëm financiar mbi menaxhimin e likuiditetit apo mbi flukset financiare të institucioneve publike përtej detyrimeve që këto institucione kanë tashmë sipas legjislacionit në fuqi.

- Gjithashtu, nuk është e mundur të parashikohen me saktësi ndryshimet e mundshme në sjelljen e operatorëve ekonomikë ose të autoriteteve publike pas miratimit të projektligjit. Megjithatë, bazuar në objektivin dhe natyrën e ndërhyrjes, pritet që harmonizimi i plotë me Direktivën 2011/7/BE të kontribuojë në rritjen e disiplinës së pagesave, përmirësimin e sigurisë juridike dhe reduktimin e mosmarrëveshjeve që burojnë nga paqartësitë e kuadrit aktual ligjor.=

3. Ndikimet jo të drejtpërdrejta

- Përmirësim i klimës së përgjithshme të biznesit.

Projektligji vendos rregulla më të qarta dhe më të detyrueshme për afatet e pagesave, kamatëvonesat automatike dhe mbrojtjen ndaj kushteve kontraktore të padrejta. Kjo redukton pasigurinë në transaksionet tregtare dhe krijon një mjedis më të parashikueshëm për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Si rezultat, bizneset operojnë në një klimë më të favorshme dhe me më pak rrezik financiar.

- Rritje e besimit në treg dhe në marrëdhëniet kontraktore.

Kur palët kanë siguri se pagesat do të kryhen brenda afateve ligjore dhe se vonesat do të shoqërohen automatikisht me kamatëvonesë, rritet besimi në respektimin e kontratave. Kjo nxit bashkëpunimin ndërmjet operatorëve ekonomikë, ul konfliktet kontraktore dhe forcon sigurinë juridike në treg.

- Stabilitet më i madh ekonomik përmes qarkullimit më të shpejtë të kapitalit.

Pagesat më të shpejta dhe reduktimi i vonesave bëjnë që fondet monetare të qarkullojnë më shpejt ndërmjet bizneseve dhe institucioneve publike. Kjo përmirëson likuiditetin e ekonomisë, redukton nevojën për financim afatshkurtër dhe kontribuon në një funksionim më efikas të aktivitetit ekonomik në tërësi.

b) Ndikimi mbi konkurrencën

Transpozimi i plotë i Direktivës 2011/7/BE pritet të ketë një ndikim pozitiv në konkurrencën në treg, duke përmirësuar kushtet e barazisë ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke reduktuar avantazhet e padrejta që krijohen nga praktikatat e pagesave të vonuara.

Së pari, vendosja e rregullave të qarta dhe të detyrueshme për afatet e pagesave dhe aplikimi automatik i kamatëvonesave kontribuon në krijimin e një mjedisi më të drejtë konkurrues, ku të gjitha ndërmarrjet operojnë mbi baza të njëjta ligjore dhe financiare. Kjo redukton mundësinë që operatorët më të mëdhenj të ushtrojnë presion financiar mbi furnitorët më të vegjël përmes vonesave në pagesa.

Së dyti, përmirësimi i likuiditetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) rrit aftësinë e tyre për të konkurruar në treg, duke u mundësuar atyre të investojnë më shumë në inovacion, zgjerim të aktivitetit dhe përmirësim të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Kjo kontribuon në rritjen e diversitetit të ofertës në treg dhe në forcimin e konkurrencës së ndershme.

Së treti, rritja e sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë në marrëdhëniet kontraktore ul kostot e transaksioneve dhe rrezikun financiar për operatorët ekonomikë, duke nxitur hyrjen e aktorëve të rinj në treg dhe duke forcuar dinamikën konkurruese.

Së katërti, rritja e konkurrencës së ndershme, pasi reduktohen avantazhet e padrejta të krijuara nga vonesat në pagesa.

Projektligji vendos kufij maksimalë për afatet e pagesës, parashikon kamatëvonesë automatike dhe shpall të pavlefshme disa kushte kontraktore të padrejta. Kjo kufizon mundësinë që operatorët ekonomikë me fuqi më të madhe negociuese ose autoritetet publike të financojnë aktivitetin e tyre në kurriz të kreditorëve përmes vonesave të pagesave. Si rezultat, konkurrenca zhvillohet mbi bazën e eficiencës dhe cilësisë së produkteve apo shërbimeve, dhe jo mbi aftësinë për të imponuar kushte të pafavorshme pagese.

Së pesti, përmirësimi i aksesit në treg për NVM-të.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë më të ndjeshme ndaj vonesave në pagesa për shkak të burimeve më të kufizuara financiare. Përmirësimi i disiplinës së pagesave dhe rritja e sigurisë së arkëtimit të detyrimeve mund të reduktojë barrierat financiare për hyrjen dhe qëndrimin e tyre në treg, duke u mundësuar pjesëmarrje më të gjerë në marrëdhënie tregtare dhe në kontratat publike.

Së gjashti, barazim më i mirë i kushteve të konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Vendosja e rregullave të njëjta për afatet e pagesës, procedurat e kolaudimit dhe llogaritjen e kamatëvonesave krijon standarde të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë. Kjo redukton diferencat që lindin nga praktika kontraktore të padrejta ose nga pozitat dominuese të aktorëve të caktuar në treg, duke kontribuar në një mjedis më të balancuar konkurrues.

Në tërësi, ndërhyrja pritet të eliminojë shtrembërimet në konkurrencë që burojnë nga vonesat në pagesa dhe të krijojë një treg më transparent, më efikas dhe më të hapur për të gjithë operatorët ekonomikë.

4. Kufizimi i analizës

Supozimet

Analiza e ndikimeve të opsionit të preferuar bazohet në disa supozime kryesore, të cilat ndikojnë në mënyrën se si janë vlerësuar përfitimet dhe kostot e ndërhyrjes, si dhe në saktësinë e parashikimeve afatshkurtra dhe afatmesme.

- Supozohet zbatim i plotë dhe i njëtrajtshëm i ligjit nga të gjitha institucionet publike.
- Supozohet rritje graduale e disiplinës së pagesave në sektorin privat.
- Supozohet që kapacitetet administrative ekzistuese janë të mjaftueshme për zbatim.
- Supozohet se sjellja e pagesave në treg do të përmirësohet në mënyrë progresive si rezultat i forcimit të kuadrit ligjor.

Rreziqet

- Rreziku i moszbatimit të plotë të dispozitave ligjore në praktikë, veçanërisht nga disa institucione publike ose operatorë ekonomikë.
- Rreziku i rezistencës nga bizneset ndaj ndryshimeve në disiplinën e pagesave, veçanërisht në sektorët ku vonesat në pagesa kanë qenë praktikë e konsoliduar.
- Rreziku i mungesës së të dhënave të plota statistikore për monitorimin e saktë të ndikimeve të ligjit.
- Rreziku i vonesave në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në përmirësimin e mekanizmave të zbatimit.

Forca e provave

- Provat mbështeten në Direktivën 2011/7/BE dhe praktikatat e vendeve të BE-së, të cilat ofrojnë një bazë të fortë krahasimore.
- Të dhënat vendase janë të pjesshme dhe kryesisht cilësore, çka kufizon mundësinë për vlerësime të sakta sasiore dhe monetare.
- Analiza bazohet kryesisht në vlerësime krahasuese dhe eksperiencat ndërkombëtare.
- Parashikimet kanë natyrë vlerësuese dhe orientuese, duke reflektuar më shumë tendenca sesa matje të sakta empirike.

Faktorë që mund të pengojnë përfitimet

- Mungesë e monitorimit efektiv institucional.
- Zbatim i pjesshëm i dispozitave për kamatëvonesat.
- Vonesa në përshtatjen e proceseve administrative.

Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.

Zbatimi i ndërhyrjes për transpozimin e Direktivës 2011/7/BE mund të përballë me një sërë faktorësh që ndikojnë në uljen e efektivitetit të saj, rrisin kostot e zbatimit ose sjellin pasoja të paparashikuara.

1. Mungesa e zbatimit efektiv institucional

Një nga faktorët kryesorë që mund të pengojë realizimin e përfitimeve është zbatimi i pjesshëm ose jo i njëtrajtshëm i dispozitave ligjore nga institucionet publike dhe subjektet private. Mungesa e monitorimit efektiv dhe e mekanizmave të kontrollit mund të reduktojë ndikimin real të reformës në disiplinimin e pagesave.

2. Kapacitetet e kufizuara administrative

Mungesa e burimeve njerëzore të trajnuara dhe kapaciteteve teknike në disa institucione mund të ngadalësojë procesin e zbatimit dhe të rrisë kostot administrative të përshtatjes me kërkesat e reja ligjore.

3. Rezistenca nga operatorët ekonomikë

Disa subjekte ekonomike mund të tregojnë rezistencë ndaj ndryshimeve, veçanërisht në lidhje me respektimin e afateve më të rrepta të pagesave dhe aplikimin automatik të kamatëvonesave, duke ndikuar në ngadalësimin e efektit të pritur të ligjit.

4. Mungesa e të dhënave të sakta dhe sistemeve të monitorimit

Pa sisteme të avancuara të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave mbi pagesat, vlerësimi i ndikimeve reale të ligjit mund të jetë i kufizuar, duke e bërë më të vështirë identifikimin e problemeve dhe ndërhyrjen në kohë.

5. Kostot e përshtatjes institucionale dhe administrative

Megjithëse kostot e përgjithshme vlerësohen të kufizuara, mund të ketë kosto të papritura të lidhura me trajnimin e stafit, përditësimin e procedurave të brendshme dhe forcimin e mekanizmave të zbatimit.

6. Faktorë ekonomikë të jashtëm

Ngadalësimi ekonomik, rritja e inflacionit ose paqëndrueshmëria e tregut financiar mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e bizneseve për të respektuar afatet e pagesave, duke kufizuar efektin pozitiv të ndërhyrjes.

7. Efekte të paparashikuara në sjelljen e tregut

Në disa raste, rregullat më të rrepta për pagesat mund të çojnë në ndryshime të sjelljes së biznesit, si për shembull kufizimi i kushteve të kreditit tregtar, që mund të ndikojë në likuiditetin e disa operatorëve ekonomikë në afat të shkurtër.

Në përmbledhje, realizimi i plotë i përfitimeve të ndërhyrjes varet nga kapaciteti institucional, shkalla e zbatimit dhe reagimi i aktorëve të tregut, ndërsa faktorët e mësipërm mund të ndikojnë në kohën dhe intensitetin e efekteve të pritshme.

5. Përmbledhje e vlerësimit të opsioneve

Krahasimi i opsioneve

Është kryer një krahasim më efikas dhe të strukturuar të opsioneve të marra në shqyrtim, është përdorur një analizë me shumë kriterë. Kjo qasje mundëson vlerësimin në mënyrë të balancuar të ndikimeve ligjore, ekonomike dhe institucionale të secilit opion, duke reflektuar efektet e tyre në afat të shkurtër dhe afatgjatë.

Opsioni 0 – Status quo (mosndërhyrja): Ky opion nuk adreson mangësitë e identifikuara në ligjin nr. 48/2014 dhe nuk siguron harmonizimin e nevojshëm me Direktivën 2011/7/BE. Megjithëse nuk krijon kosto shtesë për administratën publike dhe subjektet private, ai nuk përmirëson disiplinën e pagesave, nuk forcon mbrojtjen e kreditorëve dhe nuk kontribuon në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Opsioni 1 – Masa jorregullatore: Ky opion parashikon masa administrative, informuese dhe ndërgjegjësuere pa ndryshuar kuadrin ligjor ekzistues. Ai mund të sjellë përmirësime të kufizuara në njohjen dhe zbatimin e dispozitave aktuale, me kosto relativisht të ulëta. Megjithatë, nuk adreson mangësitë strukturore të legjisllacionit, nuk siguron harmonizimin me acquis-in e Bashkimit Evropian dhe nuk

garanton një zgjidhje të qëndrueshme për problematikat që lidhen me pagesat e vonuara në transaksionet tregtare.

Opsioni 2 – Ndryshime të pjesshme të ligjit: Ky opsion përmirëson disa elemente të kuadrit ligjor, veçanërisht ato që lidhen me afatet e pagesës, kamatëvonesat dhe procedurat përkatëse. Megjithatë, ai nuk garanton harmonizim të plotë me Direktivën 2011/7/BE dhe nuk adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha mangësitë e identifikuara, duke lënë të pazgjidhura disa çështje që lidhen me përkufizimet, fushën e zbatimit dhe mbrojtjen efektive të kreditorëve.

Opsioni 3 – Ndryshime të plota të ligjit dhe harmonizim i plotë me Direktivën 2011/7/BE (opsioni i preferuar): Ky opsion ofron zgjidhjen më të plotë dhe më efektive, pasi siguron transpozimin e plotë të Direktivës 2011/7/BE dhe adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha problematikat e identifikuara. Ai garanton përputhshmëri me *acquis-in* e Bashkimit Evropian, rrit sigurinë juridike, përmirëson disiplinën e pagesave, forcon mbrojtjen e kreditorëve dhe kontribuon në përmirësimin e likuiditetit, konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve dhe klimës së biznesit në përgjithësi.

Përfundimi i krahasimit: Nga analiza krahasuese rezulton se opsioni 3 paraqet raportin më të favorshëm ndërmjet kostove dhe përfitimeve dhe është alternativa që kontribuon më së shumti në arritjen e objektivave të politikës. Për këtë arsye, ai është përzgjedhur si opsioni i preferuar.

Përfitimi neto

Opsioni i preferuar ka **përfitim neto pozitiv afatgjatë**, i shprehur në:

1. reduktim të kostove të financimit për bizneset,
2. përmirësim të likuiditetit,
3. ulje të kostove administrative të lidhura me mosmarrëveshjet,
4. rritje të efikasitetit të tregut.

Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:

Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.

Ndërhyrja për transpozimin e plotë të Direktivës 2011/7/BE pritet të sjellë një sërë ndikimesh jo të drejtpërdrejta mbi ekonominë dhe shoqërinë, të cilat burojnë nga përmirësimi i funksionimit të përgjithshëm të tregut dhe rritja e disiplinës së pagesave.

Për shoqërinë në përgjithësi, projektligji nuk krijon detyrime apo të drejta të reja të drejtpërdrejta për qytetarët. Megjithatë, ai pritet të sjellë ndikime pozitive indirekte përmes përmirësimit të funksionimit të ekonomisë dhe marrëdhënieve tregtare.

Përmirësimi i disiplinës së pagesave dhe reduktimi i vonesave në shlyerjen e detyrimeve kontraktore pritet të forcojnë stabilitetin financiar të ndërmarrjeve, veçanërisht të NVM-ve. Kjo mund të kontribuojë në ruajtjen e vendeve të punës, në rritjen e qëndrueshmërisë së aktiviteteve ekonomike dhe në përmirësimin e ofrimit të mallrave dhe shërbimeve në treg.

Gjithashtu, pagesat më të shpejta nga autoritetet publike mund të përmirësojnë kapacitetin e operatorëve ekonomikë për të investuar, për të zgjeruar aktivitetin dhe për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit publik, duke rritur konkurrencën dhe efikasitetin ekonomik në dobi të publikut.

Në aspektin institucional, forcimi i sigurisë juridike dhe respektimi më i mirë i afateve kontraktore pritet të rrisin besimin në marrëdhëniet ndërmjet sektorit publik dhe privat, duke kontribuar në një klimë më të qëndrueshme biznesi dhe në një ekonomi më funksionale.

Për sektorin financiar, përmirësimi i disiplinës së pagesave mund të ndikojë në uljen e kërkesës për financim afatshkurtër të detyruar nga vonesat në pagesa, duke përmirësuar cilësinë e portofolit të kreditimit dhe reduktuar ekspozimin ndaj riskut të likuiditetit për bizneset.

Për administratën publike, ndërhyrja pritet të sjellë përmirësim të kulturës së menaxhimit financiar dhe forcim të disiplinës buxhetore, duke ndikuar në mënyrë indirekte në eficiencën e përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin më të mirë të detyrimeve financiare.

Në aspektin ekonomik më të gjerë, rritja e parashikueshmërisë në pagesa dhe përmirësimi i klimës së biznesit pritet të ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja dhe vendase, duke forcuar konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare në raport me tregjet rajonale dhe ato të Bashkimit Evropian.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 0 – Status quo (mosndërhyrja): Ky opsion nuk adreson mangësitë e identifikuar në ligjin nr. 48/2014 dhe nuk siguron harmonizimin e nevojshëm me Direktivën 2011/7/BE. Megjithatë nuk krijon kosto shtesë për administratën publike dhe subjektet private, ai nuk përmirëson disiplinën e pagesave, nuk forcon mbrojtjen e kreditorëve dhe nuk kontribuon në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Opsioni 1 – Masa jorregullatore: Ky opsion parashikon masa administrative, informuese dhe ndërgjegjëse pa ndryshuar kuadrin ligjor ekzistues. Ai mund të sjellë përmirësime të kufizuara në njohjen dhe zbatimin e dispozitave aktuale, me kosto relativisht të ulëta. Megjithatë, nuk adreson mangësitë strukturore të legjislacionit, nuk siguron harmonizimin me *acquis-in* e Bashkimit Evropian dhe nuk garanton një zgjidhje të qëndrueshme për problematikat që lidhen me pagesat e vonuara në transaksionet tregtare.

Opsioni 2 – Ndryshime të pjesshme të ligjit: Ky opsion përmirëson disa elemente të kuadrit ligjor, veçanërisht ato që lidhen me afatet e pagesës, kamatëvonesat dhe procedurat përkatëse. Megjithatë, ai nuk garanton harmonizim të plotë me Direktivën 2011/7/BE dhe nuk adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha mangësitë e identifikuar, duke lënë të pazgjidhura disa çështje që lidhen me përkufizimet, fushën e zbatimit dhe mbrojtjen efektive të kreditorëve.

Opsioni 3 – Ndryshime të plota të ligjit dhe harmonizim i plotë me Direktivën 2011/7/BE (opsioni i preferuar): Ky opsion ofron zgjidhjen më të plotë dhe më efektive, pasi siguron transpozimin e plotë të Direktivës 2011/7/BE dhe adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha problematikat e identifikuar. Ai garanton përputhshmëri me *acquis-in* e Bashkimit Evropian, rrit sigurinë juridike, përmirëson disiplinën e pagesave, forcon mbrojtjen e kreditorëve dhe kontribuon në përmirësimin e likuiditetit, konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve dhe klimës së biznesit në përgjithësi.

Përfundimi i krahasimit: Nga analiza krahasuese rezulton se opsioni 3 paraqet raportin më të favorshëm ndërmjet kostove dhe përfitimeve dhe është alternativa që kontribuon më së shumti në arritjen e objektivave të politikës. Për këtë arsye, ai është përzgjedhur si opsioni i preferuar. Ai përmirëson ndjeshëm disiplinën e pagesave, rrit likuiditetin e bizneseve, forcon mekanizmat e zbatimit dhe përmirëson klimën e përgjithshme të biznesit, me kosto të kufizuara për buxhetin e shtetit.

Opsioni i preferuar, siguron transpozimin e plotë të kërkesave të Direktivës 2011/7/BE dhe eliminon boshllëqet e identifikuar në kuadrin aktual ligjor. Nëpërmjet këtij opsioni parashikohen një sërë përmirësimesh që forcojnë mbrojtjen e kreditorëve dhe rrisin efektivitetin e mekanizmave për luftimin e vonesave në pagesa.

Konkretisht, projektligji sjell risi në lidhje me:

- përcaktimin më të qartë të fushës së zbatimit të ligjit;
- saktësimin dhe harmonizimin e afateve maksimale të pagesave në transaksionet tregtare, veçanërisht kur debitori është një autoritet publik;

- forcimin e të drejtës së kreditorit për të përfituar automatikisht kamatëvonesë në rast vonese në pagesë, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë;
- njohjen e të drejtës për kompensimin e kostove të rikuperimit të borxhit të shkaktuara nga vonesa në pagesë;
- vendosjen e mekanizmave më të qartë për mbrojtjen e kreditorëve nga kushtet kontraktore dhe praktikat haptazi të padrejta;
- përafrimin e terminologjisë dhe koncepteve ligjore me ato të Direktivës 2011/7/BE, duke rritur sigurinë juridike dhe zbatueshmërinë e dispozitave.

Krahasuar me opsionin e mosndërhyrjes, ky opsion eliminon mangësitë e kuadrit aktual ligjor dhe siguron përputhshmëri të plotë me acquis të Bashkimit Evropian. Ndërsa krahasuar me harmonizimin e pjesshëm, ai shmang rrezikun e ruajtjes së boshllëqeve ligjore dhe të mospërputhjeve me Direktivën, të cilat mund të vazhdonin të krijonin pasiguri juridike dhe vështirësi në zbatim.

Përfitimet e pritshme të këtij opsioni përfshijnë përmirësimin e disiplinës së pagesave në marrëdhëniet tregtare, rritjen e sigurisë juridike për operatorët ekonomikë, mbrojtjen më efektive të kreditorëve, përmirësimin e likuiditetit të bizneseve dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Njëkohësisht, zbatimi i tij nuk kërkon krijimin e institucioneve të reja apo financime shtesë të konsiderueshme nga buxheti i shtetit, pasi ndryshimet kanë karakter kryesisht normativ dhe do të zbatohen nga strukturat ekzistuese institucionale.

Për të identifikuar opsionin më të përshtatshëm të ndërhyrjes, është kryer një analizë me shumë kritere (Multi-Criteria Analysis – MCA), e cila mundëson vlerësimin krahasues të alternativave në raport me objektivat e politikës së propozuar. Vlerësimi është bazuar në një sërë kriteresh që pasqyrojnë ndikimin e secilit opsion në arritjen e objektivave të projektligjit, përfshirë harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përmirësimin e funksionimit të tregut, mbrojtjen e operatorëve ekonomikë dhe kostot e zbatimit. Secilit kriter i është caktuar një peshë sipas rëndësisë së tij në arritjen e objektivave të ndërhyrjes, ndërsa secili opsion është vlerësuar me pikë nga 1 deri në 5, ku 1 përfaqëson performancën më të ulët dhe 5 performancën më të lartë. Rezultati përfundimtar është përlogaritur duke shumëzuar pikët e secilit opsion me peshën përkatëse të kriterit.

Kriteret e përdorura për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e tyre janë si më poshtë:

- Përafrimi me acquis të Bashkimit Evropian dhe avancimi i procesit të integritetit
- Efektiviteti i pagesave në kohë për transaksionet tregtare
- Krijimi i mekanizmave për mbrojtjen e kreditorëve (vecanërisht NVM-të)
- Qartësia dhe kuptueshmëria ligjore
- Kosto-efektiviteti i zbatimit për administratën publike dhe bizneset

Rezultatet e vlerësimit për secilin opsion paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Përafrimi me acquis të BE-së dhe avancimi në procesin e integritetit	5	1 (5)	0 (0)	3 (15)	5 (25)

Efektiviteti i pagesave në kohë për transaksionet tregtare	4	1 (4)	2 (8)	3 (12)	4 (16)
Krijimi i mekanizmave për mbrojtjen e kreditorëve (veçanërisht NVM-të)	4	0 (0)	1 (4)	4 (16)	4 (16)
Qartësia dhe kuptueshmëria ligjore	4	1 (4)	1 (4)	3 (12)	4 (16)
Kosto-efektiviteti i zbatimit për buxhetin e shtetit dhe bizneset	5	1 (5)	2 (10)	4 (20)	5 (25)
Totali		18	26	75	98

Pikët totale:

Opsioni 0 (status quo): 18

Opsioni 1 (jorregullator): 26

Opsioni 2 (përmirësime të pjesshme): 75

Opsioni 3 (harmonizim i plotë – opsioni i preferuar): 98

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*

Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.

Zbatimi i ligjit të ndryshuar “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, në përputhje me Direktivën 2011/7/BE, do të realizohet nga institucionet ekzistuese përgjegjëse për mbikëqyrjen e marrëdhënieve tregtare dhe disiplinën financiare.

Njësitë kryesore përgjegjëse janë:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë, si institucioni politikëbërës dhe koordinues;
- Autoritetet inspektuese dhe mbikëqyrëse të tregut, për monitorimin e zbatimit të detyrimeve kontraktore;
- Institucionet publike buxhetore, për respektimin e afateve të pagesave;
- Sistemi gjyqësor dhe përmbarimor, për zbatimin e detyrimeve dhe kamatëvonesave në rast mosrespektimi.

2. Pengesat e mundshme për zbatimin

Gjatë zbatimit të opsionit të zgjedhur mund të shfaqen disa pengesa, përfshirë:

Zbatim jo i njëtrajtshëm i dispozitave ligjore nga institucionet publike dhe subjektet private;
Kapacitete të kufizuara administrative dhe mungesë trajnimi të mjaftueshëm për stafin përgjegjës;
Mungesë e kulturës së respektimit të afateve të pagesave në disa sektorë ekonomikë;
Vështirësi në monitorimin sistematik të pagesave dhe mbledhjen e të dhënave të sakta;
Rezistencë e mundshme nga disa operatorë ekonomikë ndaj rregullave më të rrepta për kamatëvonesat dhe afatet e pagesës.

3. Masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit

Për të siguruar arritjen e objektivave të politikës, do të ndërmerren këto masa:

- Trajnimi i stafit të institucioneve publike dhe autoriteteve mbikëqyrëse;
- Forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të pagesave në transaksionet tregtare;
- Fushata informuese për operatorët ekonomikë mbi detyrimet e reja ligjore;

4. Kërkesat e përputhshmërisë dhe zbatimit

Zbatimi i ligjit të ri kërkon respektimin e këtyre kërkesave kryesore:

- Përshtatja e plotë e legjislacionit kombëtar me Direktivën 2011/7/BE;
- Respektimi i afateve ligjore të pagesës në të gjitha transaksionet tregtare;
- Aplikimi automatik i kamatëvonesës në rast vonese të pagesës;
- Kompensimi i detyrueshëm i kostove të rikuperimit të borxhit;
- Vendosja e mekanizmave efektivë të kontrollit dhe raportimit;
- Sigurimi i transparencës dhe aksesit në informacion për subjektet e interesuara.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.

Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

1. Përshkrimi i masave të monitorimit dhe vlerësimit

Zbatimi i ligjit “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, në përputhje me Direktivën 2011/7/BE, do të shoqërohet me një sistem të strukturuar monitorimi dhe vlerësimi, me qëllim sigurimin e efektivitetit të politikës dhe identifikimin në kohë të problemeve në zbatim.

Masat kryesore përfshijnë:

- Në kuadër të zbatimit të projektligjit, institucionet përgjegjëse do të marrin masat e nevojshme administrative për monitorimin e detyrimeve të papaguara, kamatëvonesave dhe ekspozimit fiskal të autoriteteve publike. Gjithashtu, do të vlerësohet nevoja për krijimin ose përmirësimin e

mekanizmave të raportimit periodik dhe monitorimit të institucioneve me nivel më të lartë të riskut të vonesave në pagesa, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike.

- raportim vjetor nga institucionet publike mbi pagesat e kryera brenda afateve ligjore;
- mbledhje dhe analizë e të dhënave mbi rastet e pagesave të vonuara dhe aplikimin e kamatëvonesave;
- vlerësime periodike të efektivitetit të ligjit në bashkëpunim me institucionet mbikëqyrëse dhe përfaqësuesit e biznesit;
- rishikim i politikës pas një periudhe 2–3 vjeçare nga hyrja në fuqi e ndryshimeve, për të vlerësuar nevojën për përmirësime të mëtejshme.

2. Kriteret dhe treguesit e matjes së progresit

Për të vlerësuar arritjen e objektivave dhe efektivitetin e ndërhyrjes, do të përdoren këta tregues kryesorë:

- Përqindja e pagesave të kryera brenda afateve ligjore në sektorin publik dhe privat;
- Numri i rasteve të pagesave të vonuara të raportuara në vit;
- Vlera totale e kamatëvonesave të aplikuara dhe të paguara;
- Koha mesatare e pagesës në transaksionet tregtare (days payable outstanding);
- Numri i mosmarrëveshjeve ligjore të lidhura me vonesat në pagesa;
- Niveli i likuiditetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), i matur përmes treguesve financiarë të raportuar;
- Niveli i përputhshmërisë së institucioneve publike me afatet ligjore të pagesave.

Në përmbledhje, sistemi i monitorimit dhe vlerësimit synon të sigurojë zbatim efektiv të ligjit, transparencë në proces dhe mundësi për përmirësime të vazhdueshme të kuadrit ligjor në përputhje me zhvillimet në treg dhe me standardet e Bashkimit Evropian.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										

Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale										
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës										
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

MINISTËR

Delina Ibrahimaj